



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:230840
Datë: 19.12.2024
Numri i dokumentit: 06622961

Ac.nr.4160/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Qerim Ademaj, kryetar i kolegjit, Naim Mehulli dhe Arsim Hamzaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses E.Gj nga P....., të cilin e përfaqëson me prokurë B.J, avokat nga P....., kundër të paditurës SHSKUK- Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës- Ministria e Shëndetësisë në Prishtinë, të cilin e përfaqëson me prokurë D.Z, për shkak të kthimit në punë dhe kompensimit të të ardhurave personale, duke vendosur lidhur me ankesat e palëve ndërgjyqëse të parashtruara kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1186/18, të datës 14.01.2022, në seancën jopublike të mbajtur më datën 02.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHEN të themelta ankesa e paditëses E.Gj nga P..... dhe ankesa e të paditurës SHSKUK- Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës- Ministria e Shëndetësisë, Prishtinë, PRISHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1186/18, të datës 14.01.2022, dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.1186/18, të datës 14.01.2022, ka vendosur si në vijim: “I- APROVOHET PJESËRISHT SIE BAZUAR kërkesëpadia e paditëses E.Gj nga Prishtina. II- DETYROHET e paditura SHSKUK- Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës– Ministria e Shëndetësisë, Prishtinë, që paditëses t’ia kompensoj diferencën e pagës nga koeficienti 7.2 deri në koeficientin 10.8, duke filluar nga dt. 24.07.2014 e dri me dt. 31.12.2014, si në vijim dhe ate: diferencën bruto në paga në shumë prej 1,440.72€, kontributin pensional 72.04€, diferencën neto në paga në shumë prej 1,330.58€; me kamatë prej 8% nga marrja e këtij aktgjykimi deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nën kërcënimin

e përmbarimit të detyrueshëm.III- REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses, me të cilën ka kërkuar që të detyrpohej i padituri që t'a kthej paditësen në pozitën paraprake Shefe e Barnatores Qendrore në QKUK, si dhe kërkesa për diferencën e pagës mbi shumat e gjykuara, për periudhën nga dt. 21.12.2014 deri me dt. 31.12.2021.IV- DETYROHET i padituri që paditëses t'ia paguaj në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore shumë e përgjithshme prej 300.00€, në afat prej 7 ditësh, nga marrja e këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm”.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë përmes te autorizuarve te tyre kanë paraqitur:

Paditësja, duke e goditur për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohej si e bazuar ankesa dhe aktgjykimi i atakuar të priset në tërësi dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

E paditura, duke e goditur për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet ashtu qe padia e paditëses te hedhet si e pasfatshme, apo qe i njëjti aktgjykim të priset dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës të nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesat janë të themelta.

Nga provat shkresore rezulton se paditësja më datë 01.08.2013 , më të paditurën ka themeluar marrëdhënie pune në kohë te pacaktuar për pozitën „ Shefe e Barnatores Qendrore ne QKUK “ më lartësi të pagës mujore 654.37 euro. Me vendimin e komisionit disiplinor të te paditurës si organ i shkallës së parë nr. 111/14, i datës 23.07.2014, të paditurës i shqiptohet masa disiplinore „ Ulje në Pozitë ‘ ‘ duke e sistemuar ne pozitën e për arsyet të cilat janë paraqit në këtë vendim, i cili vendim ka hyrë ne fuqi më datë 24.07.2014. Kundër vendimit të nxjerrë nga organi i shkallës së parë paditësja kishte ushtruar ankesë tek organi i shkallës së dytë te të paditurës, i cili me vendimin e nxjerrë më datë 27.08.2014 nën nr. 144/14 kishte refuzuar ankesën e paditëses duke lënë ne fuqi vendimin e organit të shkallës së parë. Kundër vendimit të nxjerë nga organi i shkallës së dytë i te paditurës, e paditura kishte ushtruar ankesë edhe tek Inspektorati i Punës, i cili me vendimin përfundimtar nr. 226, i datës 09.12.2014 kishte refuzuar si të pabazë ankesën e këtu paditëses, duke lënë ne fuqi vendimet e të paditurës më të cilat paditëses i ishte shiptuar masa disiplinore „ulje ne detyrë ‘ ‘ ku në këshillën juridike këtu paditësja edhe ishte udhezuar qe ka te drejtë qe te inicoj konflikt administrativ në gjykatën kompetente.

Mbi bazën e një gjendje te tillë faktike, gjykata e shkallë së parë ne procedurën e të provuarit duke marrë për bazë kërkesën e paditëses sipas padisë se ushtruar, të precizuar se fundi herë më parashtrësën e datës 14.01.2022, ka nxjerrë provat e propozuara më vlerësimin e të cilave vjen

në përfundimin se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar, me çka edhe vendos me decidivisht si ne dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar.

Qëndrimin dhe vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, si të rregullt dhe të ligjshëm nuk e aprovon Gjykata e Apelit, për arsye se kjo gjykatë konsideron se aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 dhe 182.2 pika n) e lidhur me nenin 160.4 të LPK.

I bazuar qëndron pretendimi ankimor i palës se paditur për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) të LPK, për shkakun se sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është ne kundërshtim me vetveten dhe arsyet e dhëna ne të njëjtin aktgjykim. Përveç kësaj në aktgjykimin e ankimuar, qoftë për pjesën e aprovuar të kërkesëpadiës, qoftë për atë te refuzuar nuk janë dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare te cilat kanë pas ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato arsye të cilat janë dhënë del te jenë te paqarta, ne kundërshtim me vetveten por edhe provat shkresore.

Poqese vlerësojmë dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar rrjedh se me pikën II (dy) te dispozitivit është obliguar e paditura qe paditëses t'ia kompensoj diferencën e pagës nga koeficienti 7.2 deri ne koeficientin 10.8, duke filluar nga data 24.07.2014 e deri më datë 31.12.2014, ndërsa me pikën III (tre) të dispozitivit ka refuzuar kërkesën e paditësit për pagesë te diferencës se pagës mbi shumat e gjykuara për periudhën kohore nga data 21.12.2014 deri më datë 31.12.2021, me çka mbi bazën e një vendosje te tillë i bie qe kemi edhe aprovim të kërkesës por edhe refuzim të kërkesës për periudhën kohore 21.12.2014 deri 31.12.2014 rrethanë kjo e cila aktgjykimin e ankimuar e bënë tërësisht të paekzaminueshëm.

Përveç faktit se dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i paekzaminueshëm në pjesën e dispozitivit, gjykata e shkallës së parë për pjesën e aprovuar të kërkesëpadiës se paditësit nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme se mbi bazën e cilit fakt te provuar ka ardhur në përfundimin se kërkesa e paditësit duhet aprovuar si e bazuar, kur në bazë te provave shkresore qartazi mund te konstatohet se procedura disiplinore ndaj paditëses e cila ka pas për pasojë uljen ne pozitë, nga e paditura ishte udhëhequr konform legjislacionit ne fuqi, dhe se e paditura ndaj vendimit përfundimtar të te paditurës për masën e shqiptuar, ne gjykatën kompetente nuk kishte ushtruar padi brenda afatit të përcaktuar me legjislacionin ne fuqi, ngase ne bazë te shkresave te lëndës rrjedh se vendimin organi i shkallës së dytë pranë te paditurës e ka marrë më datë 21.08.2014, ndërsa padinë ne gjykatën e shkallës së parë del ta ketë ushtruar më datë 17.04.2018.

Nën rrethanën e tillë, gjykata e shkallës së parë del se nuk ka pas pasqyre te qartë edhe sa i përket afatshmërisë se ushtrimit të padisë nga pala paditëse, edhe pse për një gjë te tillë gjykata ka për detyrë te kujdeset vet sipas detyrës zyrtare ne kuptim te nenit 389 dhe 391 të LPK, aq me tepër kur e paditura në përgjigjen ne padi të dhënë më datë 18.10.2017 ka paraqitë kundërshtime lidhur me afatshmërinë e padisë se ushtruar nga paditësja, pretendim ky i ngritur nga e njëjta edhe përmes ankesë se ushtruar, ndërsa gjykata e shkallës së parë përkundër një kundërshtimi të tillë

bërë nga e paditura ne arsyetim të aktgjykimit të ankimuar nuk ka dhënë arsye bindëse dhe të mjaftueshme lidhur më këtë kundërshtim.

Arsyetimi gjykatës se shkallës së parë, se në rastin konkret si bazë për afatshmërinë e padisë ka marrë aktgjykimin penal të Gjykatës se Apelit PAKR nr. 434/2017, i datës 18.01.2018 më të cilin paditësja është liruar nga akuza për keqpërdorim të detyrës zyrtare, sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit është arsyetim i cili nuk ka mbështetje ne provat shkresore, pasi qe ne bazë te shkresave te lëndës rezulton se paditëses masa disiplinore e shqiptuar nga e paditura ,, ulje ne detyrë ‘’nuk i është shqiptuar si shkak i dyshimit se ka keqpërdor detyrën zyrtare për të cilën ishte udhëhequr procedura penale në gjykatë, por për shkaqe tjera te cilat janë theksuar ne vendimet e marra nga e paditura më të cilën të njëjtës ju ka shqiptuar sanksioni disiplinor i sipërmepundur.

Mbi bazën e rrethanave faktike të konstatuara si më lartë, te themelta Gjykata e Apelit i vlerëson edhe pretendimet ankimore te palëve ankuese për konstatim të gabuar dhe jo të plotë te gjendjes faktike, e cila për rrjedhojë kanë pas edhe aplikimin jo te drejtë te ligjit material, pasi qe gjykata e shkallës së parë me provat e nxjerra përveç qe nuk ka arritur qe te vlerësoj drejtë çështjen e afatshmërisë se padisë se ushtruar, po ashtu nuk ka arritur qe te vërtetoj faktet vendimtare te çështjes, se vendimet e të paditurës për ulje ne detyrë paditësen a kanë qenë te ligjshme apo jo, dhe nëse të njëjtat nuk kanë qenë te ligjshme të jep arsye pse nuk kanë qenë, qe pastaj varësisht prej hetimit të drejtë të këtij fakti, e duke marrë për bazë edhe përfundimin e nxjerrë nëse padia do te ishte e afatshme apo jo, te mund te hetonte drejtë edhe faktet qe lidhen më të drejtën e paditëses për kthimin e saj ne vendin e mëhershëm të punës para se asaj ti shqiptohej sanksioni diciplinor ,,ulje ne detyrë’’, dhe kompensimin e diferencës se pagës së kërkuar sipas padisë se ushtruar.

Nga arsyet e lartcekura Gjykata e Apelit gjeti se aktgjykimi i ankimuar duhet prishur dhe lënda duhet kthyer ne rigjykim tek gjykata e shkallës së parë, e cila ne riprocedurë udhëzohet qe fillimisht të vlerësojë çështjen e afatshmërisë se padisë se ushtruar sipas kundërshtimit të bërë nga e paditura, ku për të vlerësuar drejtë çështjen e afatshmërisë duhet të merrë për bazë faktet se kur paditësi ishte ulur ne pozitë me vendimet e nxjerra nga e paditura dhe kur i njëjti kishte ushtruar padinë ne gjykatën e shkallës së parë, më anë te se cilës ka kërkuar mbrojtjen e të drejtave te pretenduara sipas petitumit të padisë. Nëse gjykata vjen në përfundimin se padia është e afatshme, atëherë sipas propozimit të palëve duhet të nxjerrë prova ne drejtim te provuarit të faktit se vendimet e të paditurës për ulje ne detyrë paditësin a kanë qenë te ligjshme apo jo, dhe nëse vjen në përfundimin se të njëjtat kanë qenë jo te ligjshme atëherë te nxjerrë prova ne drejtim të provuarit lidhur me lartësinë e kërkesës për kompensim të diferencës se pagës, gjithnjë duke marrë për bazë edhe kontratat të cilat paditësja dhe e paditura i kanë lidhur në mes vete lidhur me themelimin e marrëdhënies se tyre të punës, qoftë ajo e datës 31.07.2013 por edhe ajo e datës 02.12.2014, më anë te se cilave me vullnetin e tyre të lirë kanë përcaktuar te drejtat dhe detyrimet e marra.

Ndërsa sa i përket vendimit të cilin gjykata do ta nxjerrë ne riprocedurë, udhëzohet qe tu përmbahet kërkesave të LPK-së, nga neni 160 paragrafi 4. Pra pa marrë parasysh mënyrën e vendosjes, ne arsyetim të vendimit më të cilin do të përfundohet procedura para asaj gjykate,

përveç tjerash duhet te tregoj dhe arsyetoj çdo pretendim te ngritur nga palët ne procedurë, qoftë ai i karakterit procedural apo material.

Nga të cekurat më lart, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (c) e LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.4160/2022, me datë 02.12.2024

Kryetari i kolegjit
Qerim Ademaj, d.v